



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI
KRYETARI

VENDIM

Nr. 10, datë 02.12.2019

**PËR MIRATIMIN E HEQJES DORË TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË
EMËRIMEVE NË DREJTËSI, ZOTIT FATRI ISLAMAJ, NGA PJESËMARRJA E
MËTJESHME NË VEPRIMTARITË DHE MBLEDHJET PËR PROCEDURAT E
VERIFIKIMIT, VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË
KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT TË INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË**

Në mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të datës 02.12.2019, ku në rendin e ditës përfshihej vendimmarrja në lidhje me shqyrtimin e gjetjeve në procedurat e verifikimit të kandidaturave për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nisur nga rrethanat që rezultuan gjatë relatimit në mbledhje të anëtares relatores znj. Margarita Buhali dhe diskutimit të gjetjeve për kandidaturën e znj. Joana Asimi Sorraj, anëtari i Këshillit z. Fatri Islamaj vlerësoi menjëherë që gjendet në kushtet e pengesës ligjore për të vijuar të marrë pjesë në procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për plotësimin e këtij vendi vakant. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 224 pika 2 të ligjit nr. 115/2016, menjëherë me konstatimin e rrethanave të pengesës ligjore, i kërkoi me shkrim Kryetarit të Këshillit të procedojë dhe disponojë sipas ligjit për miratimin e heqjes dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet dhe veprimtaritë e lidhura me këto procedura.

Në themel të motivimit të kërkesës për të proceduar me akt për miratimin e heqjes dorë dhe mospërfshirjen e tij në veprimtaritë konkrete të sipërcituara të KED, anëtari Fatri Islamaj, parashtroi rrethanën se, gjatë relatimit të gjetjeve për kandidaturën e znj. Joana Asimi Sorraj, ka ardhur në dijeni të rrethanës që kjo candidate, në funksioni e saj si këshilltare ligjore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ushtron detyrën e pranë një një komisioneri, ndërkohë që ai është në procesin e rivlerësimit kalimtar të tij, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kjo rrethanë i rezulton nga përmbajtja e shkresës me nr. 6024/2 datë 05.09.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në lidhje me këto rrethana konkrete të parashtruara nga anëtari e Këshillit, zoti Fatri Islamaj, në cilësinë e Kryetarit të KED, vlerësoj se janë të zbatueshme rregullat e përcaktuara posaçërisht në ligjin nr. 115/2016, i cili, në nenin 222, parashikon se:

“Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të Këshillit lidhur me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës, të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe të mos marrë pjesë në votimin çështjes përkatëse.”

Gjithashtu, në bazë e për zbatim të këtij Ligji, edhe në Rregulloren e Brendshme të KED, në pikën 1 të nenit 14, parashikohet se:

“ Neni 14 Procedura në rast papajtueshmërie dhe konflikti të interesit

1. Anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues, nëse ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, nuk merr pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit të lidhura me çështje që kanë për objekt përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e rregullave normative të shortit, verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, si edhe në procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante.”.

Nga ana tjetër, Ligji nr. 115/2016 dhe Rregullorja e Brendshme e KED kanë përcaktuar edhe mënyrën e procedimit në rastet kur evidentohet gjendja e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose pengesave ligjore së anëtarit të KED në raport me çështjet konkrete që ky Këshill është duke shqyrtuar ose programon të shqyrtojë në mbledhjet dhe veprimtaritë që janë në kompetencën e këtij Këshilli.

Kështu, në pikën 2 të nenit 224 të ligjit nr. 115/2016 parashikohet se :

“ Neni 224 Heqja dorë

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari. “.

Në bazë e për zbatim të këtij Ligji, edhe në Rregulloren e Brendshme të KED, në pikën 2 të nenit 14, parashikohet se:

“2. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit, anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues vjen në dijeni të rrethanave të tilla që, sipas ligjit, e vendosin atë vetë ose një anëtar tjetër, përpara njërit prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njofton menjëherë Kryetarin e Këshillit dhe deklaron arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e çështjes përkatëse.”

Nga urdhërimet dhe interpretimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, përbën kompetencë dhe detyrim për Kryetarin e Këshillit që, menjëherë, kur vjen në dijeni, të procedojë me shqyrtimin e rastit dhe të vlerësojë, sipas ligjit, ekzistencën e motiveve konkrete ligjore, të cilat janë të zbatueshme në rrethanat konkrete të konstatuara kryesisht, të parashtruara nga vetë anëtari i KED apo nga të tretë, mbi gjendjen e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo pengesës ligjore të anëtarit të KED me përmbushjen prej saj/tij të detyrave dhe kompetencave në KED për shqyrtimin e çështjeve të caktuara.

Në cilësinë e Kryetarit të Këshillit, duke pasur parasysh motivet ligjore dhe rrethanat konkrete të parashtruara me shkrim nga anëtari e KED, zoti Fatri Islamaj, si dhe në shkresën

nr.6024/2 datë 05.09.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kam ardhur në përfundimin se anëtari i KED, zoti Fatri Islamaj, me të drejtë informon dhe parashtron se gjendet në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar nga neni 222 i ligjit nr. 115/2016, duke qenë se kandidatja Joana Asimi Sorraj, në funksioni e saj si këshilltare ligjore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërkohë që ai është subjekt ir procesit të rivlerësimit të tij, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Edhe pse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit informon se ka marrë masën e menjëhershme për ndërprerjen e aksesit të znj. Joana Asimi Sorraj në dosjen e subjektit të rivlerësimit Fatri Islamaj, vlerësoj se kjo masë korrekte në kohë e sipas ligjit, gjithsesi vlen nga çasti kur është marrë e për të ardhmen dhe jo për aksesin e mundshëm etj. të saj në përmbushje të detyrave përpara kandidimit për vendin vakant të Inspektorit të lartë të Drejtësisë. Prandaj, edhe për të mënjauar, në çdo rast, edhe në dukje, gjendjen e konfliktit të interesit, vlerësoj se është vendi për të pranuar kërkesën për heqje dorë të zotit Fatri Islamaj.

Në përfundim të parashtrimeve të mësipërme, duke ushtruar kompetencën që më është ngarkuar nga pika 2 e nenit 224 të ligjit nr. 115/2016, në cilësinë e Kryetarit të KED, vlerësoj se duhet të pranohet heqja dorë e anëtarit të KED Fatri Islamaj nga pjesëmarrja në veprimtaritë dhe mbledhjet e KED për procedurat e mëtejshme të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidaturave për vendin vakant të Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 224 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”,

VENDOSA:

Pranimin e heqjes dorë të anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zotit Fatri Islamaj, nga pjesëmarrja e mëtejshme në veprimtaritë dhe mbledhjet e këtij Këshilli për procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant të Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

KRYETARI
Ardian Dhotani

